



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale, që i përket procedimit penal nr. 8, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve **Kristi Zyka** dhe **Florian Disha**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 259/2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Rudina Palloj, Flora Hajredinaj dhe Bib Ndreca, me vendimin Nr. **7**, datë **23.01.2025** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Kristi Nefail Zyka** për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer ne bashkëpunim, parashikuar nga neni 259 pg 2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **3 (tre) vite burgim**.
2. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Kristi Nefail Zyka** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
3. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Kristi Nefail Zyka** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
4. Bazuar në nenin 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Kristi Nefail Zyka** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë kohore prej **5 (pesë) vitesh**.
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florian Eshref Disha** për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer ne bashkëpunim, parashikuar nga neni 259 pg 2 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me **3 (tre) vite burgim**.
6. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit **Florian Eshref Disha** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
7. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Florian Eshref Disha** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe

- trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
8. Bazuar në nenin 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Florian Eshref Disha** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë kohore prej **5 (pesë) vitesh**.
 9. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurve solidarisht.
 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (pesëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 23.01.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar